

	<b>Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive</b>	PR-MO-001
	<i>ver. 3.0</i>	<i>Faqe 1 nga 32</i>

## **Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive**

Kjo procedurë e **Regullave të Tregut** (përfshirë edhe amendamentimet pasuese) është përpiluar në përputhje me paragrafin 7.1.1 të **Regullave të Tregut** dhe është përgatitë në përputhje me Nenin 16, parografi 1.41 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L -085).



# Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive

PR-MO-001

ver. 3.0

Faqe 2 nga 32

## PËRMBAJTJA

<b>1 HYRJE</b>	<b>3</b>
<b>2 DEFINICIONET DHE SHKURTESAT</b>	<b>3</b>
DEFINICIONET .....	3
SHKURTESAT .....	4
<b>3 PËRGJEGJËSITË</b>	<b>5</b>
3.1 PËRGJEGJËSITË E KOSTT .....	5
3.2 PALËT TREGTARE .....	5
<b>4 DOKUMENTET DHE FORMAT</b>	<b>5</b>
<b>5 PËRCAKTIMI I KAPACITETEVE TRANSMETUESE NË DISPONIM NË KUFIJTË ME ZONËN LFC TË KOSTT</b>	<b>6</b>
<b>6 KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN PËR ALOKIMIN E KAPACITETEVE</b>	<b>6</b>
<b>7 ANKANDET E KAPACITETEVE INTERKONEKTIVE</b>	<b>8</b>
7.1 ORGANIZMI I ANKANDEVE TË KAPACITETEVE INTERKONEKTIVE .....	8
7.2 ORGANIZMI I AKANDEVE NË BAZA VJETORE .....	8
7.3 ORGANIZMI I ANKANDEVE NË BAZA MUJORE .....	8
7.4 ORGANIZMI I ANKANDEVE NË BAZA DITORE .....	9
7.5 ALOKIMI I KAPACITETEVE NË BAZA BREND ALOKIMI (IDATC) .....	9
7.6 DORËZIMI I OFERTAVE TË ANKANDIT .....	9
7.7 VALIDIMI DHE VERIFIKIMI I OFERTAVE .....	10
<b>8 REDUKTIMI I TË DREJTAVE PËR TRANSFERIN FIZIK (PTR) TË FITUAR</b>	<b>11</b>
<b>9 TRANSFERIMI I TË DREJTAVE PËR TRANSFERIN FIZIK (PTR)</b>	<b>12</b>
<b>10 REALIZIMI I TË DREJTAVE PËR TRANSFERIN FIZIK (PTR)</b>	<b>13</b>
10.1 REALIZIMI I PTR REZERVAUR NË PROCEDURËN E ALOKIMIT TË EKZEKUTUAR NGA KOSTT ....	13
10.2 REALIZIMI I PTR REZERVAUR NË PROCEDURËN E ALOKIMIT TË EKZEKUTUAR NGA OPERATORI I SISTEMIT FQINJ TË TRANSMISIONIT .....	13
10.3 VLERA E PTR E NOMINUAR NË PROGRAMIN E SHKËMBIMIT NË D-1 .....	13
10.4 VLERA E SË DREJTËS SË KAPACITETIT NË NOMINIMET BREND DITËS TË PROGRAMIT TË SHKËMBIMIT	
14	
Shtojca 1.....	16
Shtojca 2.....	20
Shtojca 3.....	27
Shtojca 4.....	30
Shtojca 5.....	31
Shtojca 6.....	34

	<b>Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive</b> <i>ver. 3.0</i>	<b>PR-MO-001</b> <i>Faqe 3 nga 32</i>
--	--	--

## 1 Hyrje

- 1.1 Kjo procedurë përcakton mënyrën e alokimit të Kapaciteteve Transmetuese në Disponim (ATC) në linjat interkonektive të Rrjetit Transmetues në Kosovë me Operatorët e Sistemit të Transmetimit të vendeve fqinje.
- 1.2 Kjo procedurë përcakton kërkesat që pjesëmarrësit e tregut duhet të përbushin për të marrë pjesë në Ankandet Vjetore, Mujore, Ditore dhe Alokimin Brenda Ditor, procedurat e zhvillimit të ankandit, dhënien e të drejtës së transmetimit fizik (PTR), kushtet për qasje në tregun sekondar të së drejtës së transmetimit fizik dhe shfrytëzimin e të drejtës së transmetimit fizik.
- 1.3 Kjo procedurë përfshinë regjistrimin dhe ç'regjistrimin e Pjesëmarrësve në Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive, në përputhje me Nenin 7 dhe Nenin 10 të Rregullave të Tregut, alokimin e ATC në kufijtë e Zonës LFC të KOSTT si dhe dispozitat për nominimin e Kapaciteteve Intekonektive.
- 1.4 Kjo procedurë ka për qëllim që të sigurojnë një proces transparent për alokimin e kapaciteteve në disponim të interkoneksionit.
- 1.5 Kjo procedurë mbulon mënyrën në të cilën realizohet alokimi i ATC në periudhat kohore vjetore, mujore dhe ditore për 50% (pesëdhjetë përqind) të kapacitetit për kufijtë e Zonës Rregulluese të KOSTT të cilët nuk janë përfshirë në procesin e alokimit të organizuar nga SEE CAO.
- 1.6 Nëse në një kufi të caktuar, KOSTT dhe një operator fqnj i sistemit të transmetimit bien dakord që të bëjnë alokim të përbashkët (joint allocation) të ATC, procedura për Alokimin e ATC në atë kufi rregullohet me Marrëveshjen midis KOSTT dhe operatorit të sistemit fqnj të transmetimit, dhe me miratimin e Zyrës së Rregulatorit të Energjisë (ZRrE), dhe në atë rast kjo procedurë nuk do të jetë e zbatueshme.
- 1.7 Të gjitha informacionet e rëndësishme në lidhje me Procedurat për Alokimin e Kapaciteteve Transmetuese Interkonektive dhe kalendari për periudhat e alokimit publikohen në gjuhën shqipe dhe angleze dhe ato mund të gjenden në faqen elektronike të KOSTT (<http://kostt.com>) në mënyrë që të gjithë pjesëmarrësit e tregut të mund të marrin pjesë në kushte transparente dhe jo-diskriminuese.

## 2 Definicionet dhe Shkurtesat

- 2.1 Të gjitha definicionet dhe shkurtesat në këtë dokument paraqesin definicionet dhe shkurtesat në Rregullat e Tregut.
- 2.2 Përveç këtyre, në këtë procedurë janë përdorur definicionet dhe shkurtesat vijuese:

### Definicionet

**Ankandi** – Metodë bazuar në treg për të paraqitur ofertat për alokimin e kapacitetit transmetues interkonektiv për kufi, drejtim dhe periudhë kohore të definuar paraprakisht.

**Çmimi marginal** – Çmimi i ofertës së fundit të pranuar gjatë një ankandi.

**Kapaciteti i Alokuar** - një e drejtë e kapacitetit të alokuar në Ankand për një Pjesëmarrës.

**Kongestion (pamjaftueshmëri)** – paraqet situatën kur kërkesa për kapacet transmetues e paraqitur nga pjesëmarrësit në ankand është me e madhe se kapaciteti në dispozicion ATC në kufirin/drejtimin përkatës të publikuar nga KOSTT.



## Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive

ver. 3.0

PR-MO-001

Faqe 4 nga 32

**Mbajtësi i Të Drejtave të Transmetimit Fizik (PTR)-Pjesëmarrësi në Ankand të cilit i është dhënë e drejta e shfrytëzimit të kapacitetit transmetues apo një Pjesëmarrësi të cilit i është transferuar e drejta për kapacitet transmetues.**

**Numri identifikues i ankandit** - numri i përdorur në sistemin e informacionit të KOSTT për të shënuar çdo ankand në mënyrë të njëtrajtshme duke marrë parasysh kufirin, drejtimin dhe periudhën e ankandit.

**Numri i planifikuar i orëve të përdorimit të mundshëm të kapacitetit të alokuar** - numri maksimal i orëve gjatë një periudhe të ankandit në të cilën është e mundur të realizohet e drejta e përdorimit të kapacitetit.

**Oferta e Ankandit** – Oferta e paraqitur nga Pjesëmarrësi në Ankand me vlerë të definuar të kapacitetit të kërkuar dhe me çmim të ofruar për atë kapacitet (MW, EUR/(MW)).

**Oferta e fundit e pranuar në ankand** - Oferta e Ankandit, pranimi i së cilës së bashku me të gjitha ofertat e ankandit jep vlerën të barabartë me vlerën e ATC.

**Pala Aplikuese** – Pala e cila aplikon në KOSTT për tu regjistruar në Ankandet e kapaciteteve vjetore/mujore/ditore.

**Partner ndërkufitar** - Një pjesëmarrës në treg në një zonë tjeter kontrolli.

**Procedura e Alokimit** – Është kjo Procedurë e alokimit të të drejtave për shfrytëzimin e kapacitetit transmetues ndërkufitar.

**Periudha e ankandit** - Periudha me vlera të barabarta të Kapacitetit Transmetues në Disponim për të cilën alokimi i të drejtave për shfrytëzim bëhet përmes Ankandit. Mund të jetë një vit kalendarik, një muaj kalendarik ose një ditë.

**Shkëmbimi ndërkufitar i energjisë** - është shkëmbimi i energjisë elektrike që pjesëmarrësi i tregut në Kosovë, kryen me pjesëmarrësit e tregut ne zonat e kontrollit (OST-te) fqinje.

**Pjesëmarrës në Ankand** - Palë Tregtare e cila në Ankand ka dorëzuar Ofertë për alokimin e të drejtës për të shfrytëzuar kapacitetin, me kusht që më parë ka përmbyllur marrëveshje me KOSTT për blerjen dhe përdorimin e të drejtave të kapacitetit në kufijtë e Zonës Rregulluese të KOSTT.

**Transferimi i kapacitetit** - është transferimi i të drejtës së përdorimit të kapacitetit ndërkufitar nga zotëruesi i kapacitetit tek një pjesëmarrës tjeter i tregut.

**Zona Rregulluese e Ngarkesës dhe Frekuencës ose Zonë LFC** - Pjesë e një zone sinkrone apo e tërë zona sinkrone, fizikisht e kufizuar nga pikat e matjes në interkonektorët me zonat tjera LFC, të operuara nga një ose më shumë OST që përbushin detyrimet e rregullimit të ngarkesës dhe frekuencës.

### Shkurtesat

**AAC** – Kapaciteti tashmë i alokuar

**ATC** – Kapaciteti Transmetues në Disponim (ATC = NTC- AAC)

**CAX** - (Shkëmbimi i Zonës së Kontrollit) – Net Shkëmbimi ndërkufitar për një kufi, i pranuar dhe konfirmuar në procesin e skedulimit të ditës përpara.

**NTC** – Net Kapaciteti Transmetues (NTC = TTC-TRM)

**MKAK** – Marrëveshja Kornizë për Alokimin e Kapaciteteve

**PTR** – E Drejta për Transmetimin Fizik

	<b>Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive</b> <i>ver. 3.0</i>	<b>PR-MO-001</b> <i>Faqe 5 nga 32</i>
--	--	--

**SEE CAO** – Zyra për Ankandin e Koordinuar në EJL

**SME** – Sistemi për Menaxhimin e Energjisë

**TRM** -Kufiri i besueshmërisë së sistemit të transmetimit

**TTC** – Kapaciteti Total Transmetues

**ZRrE** – Zyra e Rregullatorit të Energjisë

### **3 Përgjegjësitë**

#### **3.1 Përgjegjësitë e KOSTT**

KOSTT do të:

- a) vë këtë procedurë në dispozicion të gjitha Palëve Tregtare që dëshirojnë të fitojnë të drejtën përfshirët e ATC;
- b) zbatojë këtë procedurë;
- c) revidojë dhe azhurnojë këtë procedurë bazuar në modifikimet e rregulloreve dhe Direktivave Evropiane përfshirë transferin e energjisë elektrike, si dhe ndryshimet në legjislacionin vendor në lëmin e energjisë elektrike.
- d) pranoj, analizoj dhe regjistroj aplikacionet për regjistrim dhe ç'regjistrim të Pjesëmarrësve në Treg që dëshirojnë të marrin pjesë në Ankandin e Kapaciteteve Interkonektive.
- e) publikoj ATC në faqen elektronike të tij përfshirë çdo periudhë të Ankandit para çdo Ankandi.

#### **3.2 Palët Tregtare**

Palët Tregtare që dëshirojnë të fitojnë të Drejtat përfshirë Transferin Fizik (PTR) duhet të:

- a) dorëzojnë aplikimin përfshirë regjistrim përfshirë pjesëmarrje në Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive,
- b) ofrojnë të gjitha informata e kërkuara nga KOSTT.
- c) dorëzojnë Ofertat e Ankandit (çmimin ne Euro dhe vlerën) tek KOSTT në përpjekja me detyrat e tyre të definuara në Rregullat e Tregut dhe në këtë procedurë.
- d) nominojnë vlerën e PTR që do të përdorin, nëpërmes nominimeve të kapaciteteve.

### **4 Dokumentet dhe format**

#### **4.1 Dokumentet dhe format e mëposhtme janë pjesë përbërëse e kësaj procedure dhe KOSTT do ti publikoj ato në faqen elektronike të saj:**

- a) Forma e Aplikimit përfshirë regjistrim përfshirë alokimin e kapaciteteve interkonektive - Shtojca 1
- b) Shabloni i marrëveshjes kornizë - Shtojca 2
- c) Formulari i Kërkesës përfshirë Transferimin e Kapaciteteve - Shtojca 3
- d) Formularin përfshirë ç'regjistrim të ankandit Shtojca 4
- e) Forma e ndryshimit të informacionit - Shtojca 5
- f) Lista e personave të kontaktit në KOSTT – Shtojca 6

	<b>Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive</b> <i>ver. 3.0</i>	<b>PR-MO-001</b> <i>Faqe 6 nga 32</i>
--	--	--

- g) Manuali i Sistemit për alokimin e kapaciteteve të KOSTT për pjesëmarrësit në ankand
- 4.2 KOSTT gjithashtu do të publikoj në faqen elektronike të saj dokumentet e mëposhtme:
- a) Kalendarin e alokimit të kapaciteteve,
  - b) Listën e pjesëmarrësve,
  - c) Tabela me vlerat e ATC për Alokimin brenda ditës (IdATC) në ditën D, më së voni deri 18:00h në ditën D-1,
  - d) Tabela me rezultate të ankandit të përgjithshëm,
  - e) Lista e pjesëmarrësve që kanë fituar PTR në ankande vjetore dhe mujore (për secilin kufi individualisht),
  - f) Tabela me rezultate të përgjithshme të alokimit brenda ditor (ID) të kapaciteteve,
  - g) Orari i planifikuar i mirëmbajtjes së linjave ndërkufitare.

## 5 Përcaktimi i kapaciteteve transmetuese në disponim në kufijtë me zonën LFC të KOSTT

- 5.1 Vlerat e kapacitetit transmetues në disponim (ATC) për periudhën vjetore, mujore dhe ditore përcaktohen për secilin kufi veç e veç dhe secilin drejtim në atë kufi, në harmoni me parimet e përcaktuara në Kodin e Rrjetit.
- 5.2 Vlerat e ATC përcaktohen çdo vit, muaj dhe ditë, sipas formulës:

$$ATC = NTC / 2 - AAC$$

- 5.3 Vlera e ATC, i cili është i disponueshëm për alokimin brenda ditës (IdATC) përcaktohet në mënyrën e përshkruar në nenin 7.5.

## 6 Kushtet për pjesëmarrje në ankandin për alokimin e kapaciteteve

- 6.1 Palët Tregtare të cilët mund të marrin pjesë në Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive duhet të:
- a) janë të licencuar sipas procedurave nga ZRR-E për:
    - (i) Prodhimin e energjisë elektrike
    - (ii) Furnizimin me energji elektrike
    - (iii) Furnizim me Shumicë (Tregtim) të Energjisë Elektrike
  - b) të kenë të nënshkruar me KOSTT Marrëveshjen për Aderim në Rregullat e Tregut;
  - c) janë të regjistruar si palë përgjegjëse për balanc (BRP);
  - d) kenë EIC kod të lëshuar nga ndonjë zyrë e autorizuar nga ENTSO-E.
- 6.2 Para se të marrin pjesë në Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive, nga Palët Tregtare gjithashtu do të kërkohet që me KOSTT të përmbyllin Marrëveshjen Kornizë për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive (MKAK).
- 6.3 Palët Tregtare që dëshirojnë të regjistrohen duhet të përdorin Formularin për Regjistrim.
- 6.4 Palët Tregtare që dëshirojnë të regjistrohen si Pjesëmarrës në Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive duhet të dërgojnë te KOSTT Formularin e plotësuar si dhe kopjen e Licencës të

Iëshuar nga ZRrE së paku 20 ditë pune para datës së parë të aktivitetit.

- 6.5 Pas pranimit të aplikacionit (Formularit të plotësuar) dhe brenda 5 (pesë) ditë pune nga data e pranimit të aplikacionit, KOSTT bën verifikimin e mjaftueshmërisë së informatave të dorëzuara nga aplikuesi.
- 6.6 Në qoftë se aplikacioni i dorëzuar është i pa kompletuar apo jo i saktë, KOSTT do të informojë Palën Aplikuese me e-mail. Nëse aplikuesi brenda një javë nuk dorëzon aplikacionin e kompletuar dhe të saktë, KOSTT do të konsiderojë se aplikacioni nuk është dorëzuar dhe nuk do ta marrë në konsideratë këtë aplikacion.
- 6.7 Në rast se aplikacioni i dorëzuar është i saktë dhe i kompletuar, KOSTT do t'ia dërgojë Palës Aplikuese MKAK me e-mail për plotësimin e të dhënave.
- 6.8 Pala Aplikuese e cili pranon MKAK është e obliguar ta nënshkruajë dhe vulosë atë dhe t'i dërgojë direkt apo përmes postës 2 kopje origjinale të MKAK te KOSTT.
- 6.9 Brenda 5 (pesë) ditë pune pasi ka pranuar MKAK të nënshkruar nga Pala Aplikuese, KOSTT do t'i nënshkruajë të dy kopjet e marrëveshjes dhe njérën do t'ia kthejë Palës Aplikuese.
- 6.10 MKAK do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të marrëveshjes nga të dy palët dhe Pala Aplikuese do të fitojë statusin e pjesëmarrësit në ankand i cili ka të drejtë të:
  - a) pjesëmarrjes në Ankand;
  - b) bëj transferin e ATC të fituara në ankand te pjesëmarrësit tjerë
  - c) pjesëmarrjës në alokimin e kapaciteteve brenda ditës (IdATC)
- 6.11 KOSTT e aprovon kërkesën e Palës Aplikuese për regjistrim si Pjesëmarrës në Ankandin e Kapacitetit Interkonektiv si në vijim:
  - a) Jo më vonë se 15 Nëntori i vitit Y-1 me qëllim që të mund të marrë pjesë në Ankandin vjetor për vitin Y.
  - b) Jo më vonë se deri në ditën e parë të muajit M-1 me qëllim që të mund të marrë pjesë në Ankandin mujor për muajin M.
  - c) Jo më vonë se dita e 15 e M-1 me qëllim që të mund të marrë pjesë në Ankandin ditor dhe brenda ditor për muajin M.
- 6.12 Palët Tregtare që dëshirojnë të ç'registrohen duhet të përdorin Formularin për ç'regjistrim.
- 6.13 Në qoftë se një Palë Tregtare nuk dëshiron më tutje të jetë e regjistruar si Pjesëmarrës në Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive, duhet të dërgoj ne KOSTT Formularin e plotësuar për ç'regjistrim, jo më vonë se 30 ditë para datës së hyrjes në fuqi të tërheqjes të përcaktuar nga pala në formularin për ç'regjistrim.
- 6.14 Ç'regjistrimi i Pjesëmarrësit në Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të ardhshëm kalendarik.
  - a) Palës Tregtare gjithashtu do ti ndërpritet e drejta për të qenë Pjesëmarrës në Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive në qoftë se dështon ti plotësojë obligimet e veta sipas MKAK, me ç'rast regjistrimi do të de-aktivizohet në përputhje me dispozitat e Nenit 6 të asaj kontrate.

## **7 Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive**

### **7.1 Organizimi i Ankandeve të Kapaciteteve Interkonektive**

- 7.1.1 KOSTT organizon ankande në periudha kohore vjetore, mujore dhe ditore, të rezervimit të drejtës së përdorimit të kapacitetit në disponim (ATC) për çdo kufi dhe drejtim.
- 7.1.2 KOSTT pas miratimit nga ZRrE, do të publikoj në faqen elektronike të tij vlerat aktuale të parashikuara të ATC për çdo kufi Interkonektiv dhe për çdo kahje për vitin që vjen. Përveç kësaj, KOSTT do të publikoj vlerat e azhurnuara për muajin e ardhshëm, duke marrë parasysh çdo informatë të re të disponueshme.
- 7.1.3 KOSTT definon Periudhat e Ankandeve të Kapaciteteve Interkonektive. Këto periudha do të janë periudha vjetore, mujore dhe ditore.
- 7.1.4 KOSTT do të bëjë alokimin e një pjese të ATC në interkonektionet e tij dhe do të jetë përgjegjës për gjysmën e ATC total (50-50) përvèç në qoftë se dakordohet ndryshe me operatorët e sistemeve transmetuese fqinjë.
- 7.1.5 Ankandet do të organizohen në mënyrë individuale për çdo periudhë të ankandit, për secilin interkonektor dhe për çdo kahje.

### **7.2 Organizimi i akandeve në baza vjetore**

- 7.2.1 Në bazë vjetore, KOSTT do të bëjë alokimin e ATC duke aplikuar metodën e Ankandit Eksplisit.
- 7.2.2 Për të gjithë kufijtë dhe të gjitha kahjet e Zonës LFC të KOSTT, vlerat vjetore të ATC do të publikohen jo më vonë se 2 javë para ditës së Ankandit
- 7.2.3 Ankandet vjetore për vitin Y do të organizohen njëkohësisht për të gjithë kufijtë dhe kahjet jo më vonë se 25 Nëntor të vitit Y-1. KOSTT publikon në faqen elektronike të tij datën e saktë dhe të gjitha informatat në lidhje me Ankandin vjetor.
- 7.2.4 Kapaciteti inerkekativ i alokuar në Ankandin vjetor aplikohet nga ora 00:00 e 1 Janarit, deri në orën 24:00 të 31 Dhjetorit.
- 7.2.5 Pas përfundimit të Ankandit Vjetor, jo më vonë se brenda 5 (pesë) ditëve të punës, KOSTT do të publikojë në faqen elektronike të tij një tabelë me të dhënat e përgjithshme rreth rezultateve të ankandit.

### **7.3 Organizimi i ankandeve në baza mujore**

- 7.3.1 Në baza mujore, KOSTT do të bëjë alokimin e ATC duke aplikuar metodën e Ankandit Eksplisit.
- 7.3.2 Vlerat mujore të ATC për muajin M do të publikohen jo më vonë se 2 javë para ditës së Ankandit.
- 7.3.3 Ankandet mujore për muajin M do të organizohen njëkohësisht për të gjithë kufijtë, dhe për të gjitha periudhat e Ankandit jo më vonë se dita e 15 kalendare e muajit M-1. KOSTT do të publikojë në faqen elektronike të tij datën e saktë dhe të gjitha informatat në lidhje me Ankandin mujor.
- 7.3.4 Kapaciteti inerkekativ i alokuar në Ankandin mujor aplikohet nga ora 00.00 (CET) të ditës së parë të muajit M të Ankandit deri në orën 24.00 (CET) të ditës së fundit të muajit të Ankandit.
- 7.3.5 Pas përfundimit të ankandit mujor, jo më vonë se brenda 5 (pesë) ditëve të punës, KOSTT do të publikojë në faqen elektronike të tij një tabelë me të dhënat e përgjithshme rreth rezultateve të ankandit.

	<b>Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive</b> <i>ver. 3.0</i>	<b>PR-MO-001</b> <i>Faqe 9 nga 32</i>
--	--	--

#### 7.4 Organizimi i ankandeve në baza ditore

- 7.4.1 KOSTT do të organizoj duke aplikuar metodën e Ankandit Eksplisit ditor për pjesën e mbetur të ATC që nuk është alokuar në ankandet mujore, apo që nuk është deklaruar për shfrytëzim nga palët fituese në ankandet mujore dhe vjetore.
- 7.4.2 Vlerat ditore të ATC për Ankandin ditor do të publikohen jo më vonë se në orën 08:30 të ditës D-1.
- 7.4.3 Ankandet ditore do të organizohen njëkohësisht për të gjithë kufijtë, të gjitha kahjet dhe për të gjitha periudhat e Ankandit deri në orën 09:30 të D-1.
- 7.4.4 Pas përfundimit të Ankandit ditor, çdo Pjesëmarrës në Ankand mund të shoh rezultatet përmes Sistemit për Menaxhimin e Energjisë për alokimin e kapaciteteve, nga ora 10:00 të D-1.
- 7.4.5 KOSTT do të publikoj në faqen elektronike të tij të gjitha informatat relevante për Ankandin ditor më së largu në orën 10:30.

#### 7.5 Alokimi i kapaciteteve në baza brenda ditore (IdATC)

- 7.5.1 Me miratimin e dyanshëm të operatorëve të sistemeve transmetuese, kapacitetet interkonektive të pashfrytëzuara mund të alokuhen në nivelin intraditor bazuar në principin ‘first come – first served’. Kufijtë, për të cilët zbatohet procedura e alokimit brenda ditës, do të publikohen në faqen elektronike të KOSTT.
- 7.5.2 KOSTT, së bashku me të gjithë operatorët fqinj të sistemit të transmetimit përcakton Kapacitetet e transmetimit të disponueshëm brenda ditës, të cilat janë të disponueshme për alokim brenda ditës (IdATC), për secilën periudhë (orë), kufi dhe drejtim.

IdATC përcaktohet sipas formulës:

$$\text{IdATC} = \text{NTC} - \text{CAX}$$

- 7.5.3 Në rast të kufizimeve shtesë në sistemin e transmetimit, KOSTT në dakordim me operatorët fqinj të sistemit të transmetimit mund të ndryshojnë vlerën e IdATC.
- 7.5.4 Vlerat e IdATC për ditën D publikohen në faqen elektronike të KOSTT jo më vonë se deri në orën 18:00 të ditës D-1.
- 7.5.5 Informacioni i përgjithshëm mbi kapacitetet e alokuara për një ditë D do të publikohet në faqen elektronike të KOSTT jo më vonë se deri në ora 18:00 të ditës D + 1.
- 7.5.6 Kapaciteti i alokuar në alokimin brenda ditës do të jetë pa pagesë.
- 7.5.7 Alokimi i IdATC do të organizohet nga KOSTT ose nga OST fqinje bazuar në një marrëveshje paraprake për alokim.

#### 7.6 Dorëzimi i Ofertave të Ankandit

- 7.6.1 Dorëzimi i Ofertave të Ankandit, si dhe pranimi i rezultateve pas kompletimit të Ankandeve vjetore, mujore dhe ditore do të realizohet vetëm nëpërmjet modulit të Sistemit SME për alokimin e kapaciteteve, ku Pala mund të qaset ne SME nëpërmjet adresës së publikuar në faqen elektronike të KOSTT <https://prod.kostt-mms.com/Auction-Client/>.
- 7.6.2 E drejta për tu qasur në SME mund të realizohet vetëm nga Pjesëmarrësit e regjistruar të cilët do të kenë një emër të shfrytëzimit dhe fjalëkalim për qasje në SME.
- 7.6.3 Në rast të mos disponueshmërisë të SME për alokimin e të drejtave të kapacitetit, ofertat do të dërgohen me faks apo e-mail në formën Formulari i paraqitjes së ofertës e cila është e publikuar në faqen elektronike.

	<b>Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive</b>	PR-MO-001
	ver. 3.0	Faqe 10 nga 32

- 7.6.4 Ofertat në Ankandet vjetore dhe mujore dorëzohen tek KOSTT ekskluzivisht në periudhën nga ora 09:00 deri në orën 13:00 të ditës së publikuar në Kalendarin e organizimit të ankandeve si “dita për dorëzimin e Ofertave për Ankand”.
- 7.6.5 Ofertat në Ankandet ditore dorëzohen tek KOSTT ekskluzivisht në periudhën nga ora 09:00 deri në orën 09:30 të D-1.
- 7.6.6 Pjesëmarrësit në Ankandet për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive mund të fitojnë të drejtën për shfrytëzimin e një pjese të ATC që korrespondon me kahjen në një kufi të caktuar dhe të alokuar në një periudhë të caktuar të alokimit vjetor ose mujor. Kahja e transaksionit interpretohet nga pikë vështrimi i sistemit të Kosovës.
- 7.6.7 Në Ankandet vjetore, mujore dhe ditore vlera e kapacitetit në Oferta të Ankandit, si dhe Kapaciteti i Alokuar nga ana e KOSTT paraqet kapacitetin me vlerë konstante në MW për çdo orë dhe gjatë tërë Periudhës së Ankandit.
- 7.6.8 Çdo Ofertë e Ankandit përmban një kod identifikues unik EIC (Energy Identification Code) në përpunthje me kërkesat e ENTSO-E që i atribuohet Pjesëmarrësit në Ankand, datën dhe orën e regjistrimit të Ofertës së Ankandit dhe numrin e versionit.

## 7.7 Validimi dhe Verifikimi i Ofertave

- 7.7.1 Palët pjesëmarrëse në ankandet vjetore dhe mujore mund të dorëzojnë maksimalisht 5 (pesë) Oferta.
- 7.7.2 Vlera minimale e kapacitetit në një Ofertë të Ankandit është 1 MW kurse vlera maksimale është 50 MW. Vlera e kapacitetit në një Ofertë të Ankandit duhet të jetë numër i plotë. Në raste specifike, kur ATC është më i vogël se 50 MW, vlera maksimale e kapacitetit në një Ofertë të Ankandit është e barabartë me vlerën e ATC.
- 7.7.3 Paraqitura e çmimit në Ofertë të Ankandit është i obligueshëm dhe duhet të jetë në EUR/(MW) me dy decimalë. Çmimi më i ulët në Ofertë të Ankandit duhet të jetë më i madh se zero, d.m.th. duhet të jetë minimum 0,01 EUR/MW.
- 7.7.4 Në qoftë se shuma e kapaciteteve të kërkua është më e vogël apo e barabartë me ATC, pra nuk ka kongestion, atëherë të gjitha Ofertat e Ankandit do të pranohen dhe çmimi për alokimin e kapacitetit është zero (0 EUR/MW).
- 7.7.5 Në qoftë se shuma e kapaciteteve të kërkua është më e madhe se ATC, pra ka kongestion, Ofertat e Ankandit renditen nga çmimi më i lartë kah çmimi më i ulët për çdo kufi dhe për çdo kah.
- 7.7.6 Të gjitha Ofertat e Ankandit deri në ofertën e cila e plotëson kapacitetin transmetues të disponueshëm janë oferta fituese.
- 7.7.7 Çmimi i ofertës së fundit paraqet çmimin e Ankandit (Çmimin Margjinal), që paguhet nga të gjithë Palët Pjesëmarrëse që kanë fituar të drejtën për shfrytëzimin kapacitetit.
- 7.7.8 Në qoftë se oferta e fundit e pranuar tejkalon vlerën e ATC të mbetur, Oferta e Ankandit do të pranohet vetëm për ATC të mbetur. Në qoftë se ekzistonë më shumë se një Ofertë e Ankandit me çmimin e fundit, atëherë kapaciteti i disponueshëm i mbetur do të ndahet proporcionalisht ndërmjet tyre.
- 7.7.9 Pjesëmarrësit në Ankand të cilët kanë fituar të drejtën për kapacitet janë të obliguar të paguajnë Pagesën për PTR sipas formulës vijuese.

$$PPTR = \sum_{j=1}^n (\zeta M_j \cdot KA_j)$$

Ku:

*PPTR* - Pagesa për të Drejtat e Transferit Fizik

*ζM* - Çmimi Margjinal për periodën e barazimit përfundimtar j

*KA* - Kapaciteti i Alokuar për periodën e barazimit përfundimtar j

*n* - Numri periodave të barazimit përfundimtar

7.7.10 PTR e kontraktuar si dhe detyrimet për pagesa në lidhje me PTR duhet të paguhen për tërë periudhën e Ankandit, pa marrë parasysh rrjedhat e nominuara ose kapacitetin aktual në disponim. Pagesat për PTR të fituara në Ankandet Vjetore do të bëhen në baza mujore.

7.7.11 Marrëveshja Kornizë për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive përcakton faturimin dhe afatet për pagesa si dhe obligimet.

## 8 Reduktimi i të Drejtave për Transferin Fizik (PTR) të fituar

- 8.1.1 KOSTT është i obliguar të bëjë të gjitha përpjekjet që të mundësoj realizimin **PTR** të alokuara në Ankandet vjetore, mujore dhe ditore.
- 8.1.2 Shfrytëzimi i **PTR** të fituara në Ankandet për Kapacitetet Interkonektive garantohet për kushtet normale në sistem.
- 8.1.3 Mbajtësve të **PTR** që duhet të shfrytëzojnë **PTR** të cilat u janë alokuar në cilindo kufi/kah në Ankandet vjetore mund tu reduktohet shfrytëzimi i një pjese ose tërë **PTR** brenda një periudhe të caktuar kohore për shkak të shkyçjeve të planifikuara vjetore të linjave interkonektive për mirëmbajtje të rregullta, për shkak të Forcës Madhore ose për shkak të ngjarjeve tjera të paplanifikuara /të paparashikuara në sistemin elektroenergetik.
- 8.1.4 Në rast të reduktimit të **PTR** të alokuara në Ankandin vjetor për shkak të shkyçjeve të planifikuara të linjave interkonektive për remonte të rregullta ose për mirëmbajtje, Mbajtësit e **PTR** do të njoftohen me kohë për vlerat e **PTR** që nuk mund të shfrytëzohen dhe për arsyet e këtyre kufizimeve, jo më vonë se në ditën e 12 të muajit M-1 për kapacitetin që do të shfrytëzohet në muajin M. Të gjithë Mbajtësit e PTR do të njoftohen para Ankandit të rregullt mujor për muajin M.
- 8.1.5 Në rast të reduktimit të **PTR** të alokuara në Ankandin vjetor, për shkak të shkyçjeve të planifikuara të linjave interkonektive për remonte të rregullta ose për mirëmbajtje, Pagesën për të Drejtat për Transferin Fizik (PPTR) do ti llogaritet pjesëmarrësit në ankand vetëm për atë periudhë kohore të muajit kur ajo mund të përdorë të drejtën e tërë ose një pjesë të kapacitetit.
- 8.1.6 Në rast të reduktimit të **PTR** të alokuara në Ankandin vjetor, mujor dhe ditor, për shkak të ngjarjeve të paplanifikuara në sistemin elektroenergetik, KOSTT është i obliguar të kthejë PPTR brenda 15 ditësh nga dita e reduktimit të PTR. Ndërsa në rastin e Forcës Madhore, KOSTT është i obliguar të kthejë PPTR në rast të reduktimit të **PTR** të alokuara në Ankandin vjetor dhe mujor, kurse në rast të reduktimit të **PTR** të alokuara në Ankandin ditor, Pjesëmarrësi i regjistruar i prekur nga ngjarja nuk ka të drejtë të marrë ndonjë rimbursim ose kompensim në lidhje me ose si

	<b>Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive</b> <i>ver. 3.0</i>	<b>PR-MO-001</b> <i>Faqe 12 nga 32</i>
--	--	---

pasojë e Forçës Madhore. Kthimi i pagesës do të bëhet sipas çmimit marginal, për vlerën e kapacitetit të zvogëluar dhe për të gjitha orët kur **PTR** ishte reduktuar.

- 8.1.7 Të gjitha Kapacitetet e kontraktuara do të reduktohen proporcionalisht në rast të reduktimit të ATC.
- 8.1.8 Pjesëmarrësit në Ankand do të informohen pas kthimit të sistemit në kushte të operimit normal.

## 9 Transferimi i Të Drejtave për Transferin Fizik (**PTR**)

- 9.1 Pjesëmarrësi në Ankand të cilit i janë alokuar **PTR**, nuk mund t'ia kthejë KOSTT-it një pjesë ose tërë **PTR** të alokuara, pa marrë parasysh arsyet për paaftësinë e tij për të shfrytëzuar Kapacitetin e Alokuar.
- 9.2 Pjesëmarrësit në Ankand mund ti transferojnë të drejtat e fituara në ankandet vjetore për shfrytëzimin e **PTR**. Transferi i këtyre të drejtave mund të bëhet për një pjesë apo për tërë kapacitetin e fituar.
- 9.3 Në ankandet mujore, transferi mund të bëhet vetëm për periudhat një muajshe. Mbajtësi i **PTR** mund të bëjë transferimin e kapacitetit në tërsësi (vlera e plotë e PTR të alokuara për të gjitha orët e ditës) ose pjesërisht (për një pjesë për të gjitha orët e ditës), që do të thotë në vlerë të njëjtë për tërë ditën. Në qoftë se jo, KOSTT do ta anulojë një transferim të tillë.
- 9.4 Të gjitha obligimet legale dhe obligimet për pagesat që duhet ti bëhen KOSTT mbeten tek Mbajtësi i **PTR** fillestar.
- 9.5 Palët mund të transferojnë **PTR** duke treguar me palët tjera të regjistruara në KOSTT. Këto transferime duhet ti njoftohen KOSTT përmes formularit për transferim për Nominimet Interkonektive.
- 9.6 Transferimi i **PTR** mund të bëhet vetëm për të drejtat për kapacetet të alokuar në Ankandet vjetore ose mujore.
- 9.7 Transferimi i **PTR** mund të realizohet më së voni deri në orën 12:00 tri ditë para ditës së parë të shfrytëzimit të së drejtës për kapacetet. Pas këtij afati të fundit transferimi i **PTR** nuk është i mundur.
- 9.8 Palës të cilit iu ka transferuar e drejta për shfrytëzimin e kapacitetit do të fitojë statusin e Mbajtësit të **PTR**.
- 9.9 KOSTT do të bëjë menjëherë verifikimin e Transferit të **PTR** në krahasim me Regjistrin e Kapaciteteve Interkonektive dhe do të:
  - a) refuzoj Transferin e **PTR** në qoftë se Mbajtësi i **PTR** fillestar nuk i ka kryer obligimet financiare për **PTR**; ose
  - b) miratojë Transferin e **PTR**.
- 9.10 Në qoftë se KOSTT e refuzon një propozim për Transfer të **PTR**, ai do ta njoftojë sa më shpejt që është e mundur Palën propozuese të tregtimit duke dhënë arsyet për refuzim.
- 9.11 Pala të cilit **PTR** i është alokuar në alokimin një ditë-para (D-1), nuk mund të bëjë transferimin e **PTR** tek Pjesëmarrësit tjerë.

	<b>Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive</b> <i>ver. 3.0</i>	<b>PR-MO-001</b> <i>Faqe 13 nga 32</i>
---	--	---

## 10 Realizimi i të Drejtave për Transferin Fizik (PTR)

### 10.1 Realizimi i PTR rezervuar në Procedurën e Alokimit të ekzekutuar nga KOSTT

10.1.1 Palët Tregtare do të realizojnë **PTR** të rezervuara gjatë alokimit të ekzekutuar nga KOSTT në mënyrë direkte nëpërmes nominimit të programeve të shkëmbimit ndër-kufitar.

### 10.2 Realizimi i PTR rezervuar në Procedurën e Alokimit të ekzekutuar nga operatori i sistemit fqinj të transmisionit

10.2.1 Në rast se e drejta e përdorimit të kapacitetit jepet nga Operatorët fqinjë, pjesëmarrësi i tregut që e përfiton këtë të drejtë është i detyruar të njoftojë KOSTT nëpërmjet një formati të definuar nga KOSTT, dhe që dërgohet me e-mail ose faks në KOSTT, jo më vonë se tre ditë pune para fillimit të muajit përkatës ose para ditës kur PTR bëhet efektiv.

10.2.2 Nëse nga operatori fqinjë përfundon fituesit e **PTR** nga KOSTT kërkohet partner ekskluziv, atëherë pala duhet ti nënshtrohet rregullave të OST fqinje.

10.2.3 Vlerat e nominuara në skedulimin ndërkuftare nuk mund të tejkalojnë kapacitetin total të transmetimit të alokuar përfundon fituesit e **PTR**.

### 10.3 Vlera e PTR e Nominuar në Programin e Shkëmbimit në D-1

10.3.1 **PTR** të fituara në procedurën e Alokimit të ekzekutuar nga KOSTT ose nga operatorët e sistemeve transmetuese fqinje do të realizohet nëpërmes nominimeve të programeve të shkëmbimeve ditore në përputhje me Rregullat e Tregut.

10.3.2 Në procesin e nominimit të shkëmbimeve ndërkuftare, KOSTT aplikon principin e bazuar në **PTR** të fituar.

10.3.3 Vlera e energjisë së definuar në programin e shkëmbimit ndërkuftare nuk guxon të tejkalojë vlerën e **PTR**.

10.3.4 Me qëllim të shfrytëzimit të **PTR** të fituar nga Ankandi vjetor apo mujor, Pala Tregtare duhet të deklaroi shfrytëzimin e Kapacitetit Transmetues tek KOSTT në përputhje me kërkosat e KOSTT, jo më vonë se në orën 08:00 në (D-1) ne formatin e definuar nga KOSTT (Excel fajl).

10.3.5 Për të gjitha Nominimet e **PTR** të alokuara në baza Vjetore/Mujore të verifikuar me sukses, KOSTT do të dërgojë palëve Aprovimin e Nominimit të **PTR** deri në orën 15:30 të D-1.

10.3.6 Me qëllim të shfrytëzimit të **PTR** të fituar nga Ankandi ditor, Pala Tregtare duhet të dorëzojë një Nominim përfundon fituesit e **PTR** tek KOSTT në përputhje me Rregullat e Tregut, jo më vonë se në orën 14:30 në (D-1).

10.3.7 Të gjitha Nominimet e **PTR** do të dorëzohen nëpërmes sistemit elektronik dhe në formatin e definuar nga KOSTT.

10.3.8 Nominimet e **PTR** që janë në përputhshmëri me këto procedura do të bëhen Nominime të miratuara të **PTR**.

10.3.9 Në qoftë se një Nominim i **PTR** nuk është në përputhshmëri me të gjitha kërkosat e kësaj procedurë atëherë do të refuzohet nga ana e KOSTT dhe ky Nominim i **PTR** do të shënjohet si i refuzuar.

10.3.10 Kur një Nominim i **PTR** të jetë refuzuar, KOSTT do ta njoftojë sa më parë që është e mundur palën që e ka dorëzuar këtë nominim.



## Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive

PR-MO-001

ver. 3.0

Faqe 14 nga 32

10.3.11 Për të gjitha Nominimet e **PTR** të alokuara në baza ditore që janë verifikuar me sukses, KOSTT do të dërgojë Aprovimin e Nominimit të **PTR** deri në orën 15:30 të D-1.

10.3.12 Afatet e nominimit të **PTR** mund të ndrrojnë në varësi të marrëveshjeve të KOSTT-it me OST fqinje.

### 10.4 Vlera e së drejtës së kapacitetit në nominimet brenda ditës të programit të shkëmbimit

10.4.1 Në procesin e nominimit ndërkuftar, KOSTT zbaton parimin e nominimit bazuar në vlerën e **PTR** të alokuar në alokimin brenda ditës.

10.4.2 Të gjitha Nominimet e **PTR** do të dorëzohen nëpërmes sistemit elektronik dhe në formatin e definuar nga KOSTT.

10.4.3 Nëse tashmë është pranuar programi ditor, shkëmbimet ndërkuftare brenda ditës i shtohen programit ditor të pranuar tashmë dhe palët njoftohen për Programin e azhurnuar të shkëmbimit.

10.4.4 Në rast të një mospërputhje midis shkëmbimeve ndërkuftare brenda ditës të njoftuara për të dy palët e kufirit ose midis shkëmbimeve të brendshme brenda ditëve të njoftuara nga Pjesëmarrësit, KOSTT ka të drejtë të ndryshojë, përkatësisht të vendosë vlera zero në shkëmbimet e njoftuara brenda ditës.

10.4.5 Jo më vonë se 30 minuta para fillimit të periudhës (orës) për të cilën njoftohet nominimi i shkëmbimit brenda ditës, orari i shkëmbimit do të pranohet ose refuzohet plotësisht.

10.4.6 Nëse Pjesëmarrësi më shumë se tre herë nuk e përdor të drejtën e kapacitetit të fituar në shumën e plotë që i është alokuar në alokimin brenda ditës, KOSTT do të pezullojë pjesëmarrjen e këtij pjesëmarrësi nga procesi i alokimit të kapaciteteve brenda ditës për periudhën tre muaj.

### Shtojca 1

#### APLIKACIONI PËR REGJISTRIM NË ANKANDIN E KAPACITETEVE INTERKONETKTIVE

për periudhën dd.mm.yyyy - dd.mm.yyyy

Ju lutem komplettoni formën dhe dërgojeni në KOSTT: Ndërtesa e KOSTT, Rr. Isa Boletini. Nr. 39 10000 Prishtinë , Republika e Kosovës ose permes email adreses: schedule1@kosstt.com

Ref	Kërkesat për informata	Detajet e Palës
	Emri i plotë i kompanisë	
	Adresa (zyra qendrore) e kompanisë	
	Kodi i regjistrat i kompanisë	
	Numri i identifikimit tatimor (PIB)	
	Numri i TVSH-së vetëm për personat	



## Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive

PR-MO-001

ver. 3.0

Faqe 15 nga 32

1	juridik të huaj	
	Të dhënat mbi përfaqësuesin tatimor (emri, adresa zyrtare, numri i identifikimit tatimor) vetëm për personat juridikë të huaj	
	Nr. e Licencës të lëshuar nga ZRrE	
	Adresa për dërgimin e marrëveshjeve	
	E-mail për dërgimin e marrëveshjeve	
2	Numri i llogarisë bankare	
3	Emri dhe mbiemri i drejtorit	
	Nr.i telefonit	
	Nr.i faksit	
	E-mail	
4	Personi (ose personat) përgjegjës për çështjet financiar	
	Nr. i telefonit	
	Nr. i faksit	
	E-mail	
	E-mail për dërgimin e faturave	
5	Personi (ose personat) përgjegjës për pjesëmarrje në procedurën e alokimit	
	Nr. i telefonit	
	Nr. i faksit	
	E-mail	



## Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive

PR-MO-001

ver. 3.0

Faqe 16 nga 32

6	Personi (ose personat) përgjegjës për dërgimin e nominimeve, dhe ky person duhet të jetë i disponueshëm 24 orë në ditë, 365 ditë në vit	
	Nr.i telefonit	
	Nr.i faksit	
	E-mail	
	E-mail zyrtare për paraqitjen dërgimin e nominimeve dhe mesazhet në këtë kontekst	
7	Personi (ose personat) përgjegjës për paraqitjen e çertifikatës së tregtisë së energjisë elektrike	
	Nr. i telefonit	
	Nr. i faksit	
	E-mail	
8	Kodi EIC lëshuar nga EIC zyra e lëshimit e autorizuar nga ENTSO-E	

Ne deklarojmë se Detajet e Palës Aplikuese (paraqit emrin e plotë ligjor të kompanisë) të paraqitura janë komplete dhe të sakta.

[SHKRUAJ: EMRI I KOMPANISË]

[SHKRUAJ: Emri dhe Mbiemri i PERSONIT TË AUTORIZUAR]

[SHKRUAJ: TITULLI PERSONI I AUTORIZUAR]

[HAPËSIRA PER: NENSHKRIMIN E PERSONIT TE AUTORIZUAR]

[HAPËSIRA PËR: VULËN E KOMPANISË]

	<b>Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive</b>	PR-MO-001
	ver. 3.0	Faqe 17 nga 32

## SHTOJCA 2

### KONTRATA KORNIZË

**PËR ALOKIMIN E KAPACITETIT INTERKONEKTIV TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT TË KOSOVËS  
NDËRMJET**

**OPERATORI I SISTEMIT, TRANSMISIONIT DHE TREGUT, SH.A DHE [PALA KONTRAKTUESE PËR  
KAPACITET]**

Nr. ..... / .....

### 1 PALËT KONTRAKTUESE

**OPERATORI I SISTEMIT, TRANSMISIONIT DHE TREGUT, KOSTT SH.A.**, kompani e themeluar në bazë të legjislacionit të Kosovës, me nr. të regjistrimit të biznesit 70325350, selia e së cilës është e regjistruar në Rr. Isa Boletini nr.39, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës;

dhe

**[PALA KONTRAKTUESE E KAPACITETIT]**, kompani me selinë ....., e regjistruar me [Zyra e Regjistrimit Tregtar] me nr. ...., Kodi Unik i Regjistrimit nr. ...., IBAN llogaria bankare ....., e hapur në ....., e përfaqësuar nga ....., duke vepruar si Palë Kontraktuese e Kapacitetit, (tutje e quajtur "PKK")

Tutje të dyja të quajtura *palët*.

Duke marrë parasysh:

1. Kërkesën nr..... e PKK lidhur me regjistrimin si pjesëmarrës në ankandet për alokimin e kapacitetit interkonektiv të Sistemit të Transmisionit të Kosovës.
  2. Licencën nr..... të PKK për tregtimin, gjenerimin ose furnizimin e energjisë elektrike.
  3. Procedurën operative "PR-MO-001 Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive".
  4. Dispozitat e Rregullave të Tregut siç janë të miratuara aktualisht nga ZRrE.
  5. Dispozitat e Kodit të Rrjetit siç janë aktualisht të miratuara nga ZRrE.

## *Palët pajtohen për sa vijon:*

## 2 OBJEKTI I KONTRATËS

- 2.1 Objekti i kontratës përbëhet nga alokimi i kapacitetit interkonektiv të Sistemit të Transmisionit të Kosovës nga KOSTT sipas kushteve të procedurës operative "PR-MO-001 Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive, tutje *Procedura*, dhe rregullores për marrëdhëniet ndërmjet palëve në lidhje me obligimet financiare dhe metodat e pagesës për shërbimet e kryera.
  - 2.2 PKK kuption dhe pajtohet me faktin se e drejta e qasjes në çfarëdo pike të interkonekcionit të Sistemit të Transmisionit të Kosovës mund të jepen vetëm me kusht që PKK ka të alokuar kapacitetin ineterkonektiv në pikën përkatëse sipas Procedurës.

### **3 OBLIGIMET E PALËS KONTRAKTUESE TË KAPACITETIT**

### **3.1 PAJTUESHMËRIA ME PROCEDURË**

- 3.1.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, PKK ndërmerr masat që të jetë në pajtueshmëri dhe të pranoj të gjitha përgjegjësitë dhe obligimet e përcaktuara në këtë Procedurë.

### 3.2 REGJISTRIMI

- 3.2.1 PKK që dëshiron të jetë fituese e PTR duhet të paraqesë kërkesë për regjistrim.
  - 3.2.2 Nëse paraqitet ndonjë ndryshim në të dhënrat identifikuase të PKK, PKK ndërmerr masa që menjëherë të njoftoj KOSTT me shkrim në mënyrë që të azhurnohet Regjistri i Ankandit.

### **3.3 PAGESA E FATURAVE**

- 3.3.1 PKK ndërmerr masat që të paguaj tërësisht dhe sipas afatit faturat e lëshuara nga KOSTT. Duke dorëzuar një ofertë për kapacitetin interkonektiv, PKK merr obligimin që të paguaj nëse ka sukses.
  - 3.3.2 PKK do të kryej pagesën për rezervimin e së drejtës së kapacitetit për secilin kufi, drejtimin dhe periudhën për të drejtën e caktuar (PPTR) në ankandet vjetore, mujore, ditore.

#### **4 TË DREJTAT E PALËS KONTRAKTUESE TË KAPACITETIT**

#### **4.1 PJESËMARRJA NË ANKAND**

- 4.1.1 PKK ka të drejtë të marrë pjesë në ankandet e organizuara për alokimin e kapacitetit interkonektiv në pajtim me dispozitat e Procedurës.

#### **4.2 TËRHEQJA E STATUSIT TË PJESËMARRËSIT TË ANKANDIT**

- 4.2.1 Nëse PKK nuk dëshiron që edhe më tutje të jetë i regjistruar si pjesëmarrës i ankandit, është e obliguar të njoftoj KOSTT me shkrim në një format sipas Procedurës.

	<b>Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive</b>	<b>PR-MO-001</b>
	ver. 3.0	Faqe 19 nga 32

#### **4.3 PËRDORIMI DHE TRANSFERI I KAPACITETIT TË KONTRAKTUAR**

- 4.3.1 Kapaciteti interkonektiv i caktuar në ankande dhe i kontraktuar me këtë kontratë mund të transferohet tërësisht ose pjesërisht te një pjesëmarrës tjetër i regjistruar sipas Procedurës.
- 4.3.2 PKK ka të drejtë të përdorë kapacitetin interkoenktiv të marrë sipas kushteve të përcaktuara në Procedurë.
- 4.3.3 PKK mund të transferojë PTR-në e tyre të dhënë në ankand vjetor ose mujor tek një Pjesëmarrës tjetër. Një transferim i tillë mund të bëhet për shumën e plotë ose një pjesë të kapacitetit të dhënë në pajtueshmëri me përcaktimet në Procedurë.

### **5 OBLIGIMET E KOSTT**

#### **5.1 PAJTUESHMËRIA ME PROCEDURËN E ALOKIMIT**

- 5.1.1 KOSTT është i obliguar të jetë në pajtueshmëri me përcaktimet në Procedurë.

#### **5.2 REGJISTRIMI**

- 5.2.1 KOSTT është i obliguar të regjistroj PKK në Regjistrin e Ankandit dhe njoftoj palët e interesuara, në pajtim me përcaktimet në Procedurë.

#### **5.3 ALOKIMI I KAPACITETIT TË DISPONUESHËM PËR TRANSFER**

- 5.3.1 KOSTT do të alokoj Kapacitetin e Disponueshëm Transferues (ang. Available Transfer Capacity - ATC) për PKK vetëm në pajtim me Procedurën.
- 5.3.2 Kapaciteti i Kontraktuar është jo-definitiv në rast të kushteve të pa pritura të rrjetit ose situatat emergjente në sistemin elektroenergjetik të Kosovës ose vendeve fqinje që rezulton në shkurtimin ose anulimin e të drejtave të përdorimit të Kapacitetit të Kontraktuar nga KOSTT në pajtueshmëri me përcaktimet në Procedurë.

#### **5.4 FATURIMI**

- 5.4.1 Pas ankandit, KOSTT është i obliguar të lëshoj faturën e cila përmban vlerën e kapacitetit të alokuar për PKK nga ankandi dhe çmimi i ankandit. Në rast të ankandeve vjetore, fatura lëshohet në baza mujore, siç përcaktohet në nenin7 te MKAK.

### **6 TË DREJTAT E KOSTT**

#### **6.1 DE AKTIVIZIMI I PKK**

- 6.1.1 Nëse PKK nuk përmbush obligimet e përcaktuara në këtë kontratë, KOSTT ka të drejtë të de aktivizoj PKK me një njoftim paraprak prej dy (2) javë. Nëse PKK përmbush obligimet e veta brenda afatit të specifikuar në njoftim paraprak, KOSTT menjëherë do ta riaktivizoj atë. PKK rimerr të gjitha të drejtat dhe obligimet e veta me ri-aktivizim.

#### **6.2 REVOKIMI I NJË PJESËMARRËSI TË ANKANDIT**

- 6.2.1 KOSTT ka të drejtë të revokoj atributin e PKK si pjesëmarrës i ankandit, nëse PKK:

- a) Bankoton ose është në likuidim ligjor;
- b) Nuk përmbush obligimet e veta në baza të rregullta;

- c) Është de aktivizuar dhe ka tejkaluar afatin e caktuar për përbushjen e obligimeve të mbeturë;
- d) Është gjetur të jetë në shkelje të Kapitullit 3.4 të Rregullave të Tregut;
- e) I është revokuar licenca nga ZRRE: ose
- f) Vendos të heq dorë nga statusi i tij i pjesëmarrësit të ankandit.

6.2.2 Revokimi i atributit të PKK si pjesëmarrës i ankandit është një arsyé për anulimin e kësaj Kontrate.

### **6.3 PAGESA E FATURËS**

6.3.1 KOSTT ka të drejtë inkasoj tërësisht dhe me kohë faturat e lëshuara për PKK lidhur me kapacitetin e kontraktuar si pasojë e implementimit të Procedurës.

## **7 FATURIMI DHE PAGESA**

### **7.1 FATURIMI**

- 7.1.1 Brenda dy (2) dite të punës nga data e ankandit dhe jo më vonë se dhjetë (10) ditë para fillimit të muajit vijues, përkatësisht muajit në të cilin ushtronhet e drejta për të përdorur kapacitetin ndërkufitar të alokuar, KOSTT do të lëshoj një pro-faturë për PKK për të drejtën e kapacitetit në ankandet vjetore dhe mujore. Fatura do t'i dërgohet me email PKK, ndërsa originali me postë.
- 7.1.2 Fatura për muajin përkatës në ankand vjetor duhet të dorëzohet jo më vonë se dita e 25-të e muajit paraprak të muajit të shfrytëzimit të kapacitetit.
- 7.1.3 Fatura për kapacitetin e alokuar në ankand ditor do të dorëzohet pas përfundimit të muajit në të cilin është përdorur kapaciteti.
- 7.1.4 PPTR i alokuar për pjesëmarrësit në ankandet mujore, vjetore, do të llogaritet çdo muaj, sipas formulave nga neni 7.7.9 të Procedurës.
- 7.1.5 Udhëzimet e pagesës do të shënohen në pro-faturën/faturën.

### **7.2 PAGESA**

- 7.2.1 Për të përdorur të drejtën e kapacitetit të alokuar në ankandet vjetore dhe mujore, PKK do të bëjë pagesën e të gjitha detyrimeve të duhura ndaj KOSTT, paraprakisht, për çdo muaj, në shumën dhe mënyrën e deklaruar në pro-faturën / faturën.
- 7.2.2 PKK do të bëj pagesën për rezervimin e së drejtës së kapacitetit për çdo kufi, drejtim dhe periudhë (PPTR) për të drejtën e alokimit në ankandet vjetore dhe mujore në përputhje me procedurën.
- 7.2.3 Pro-fatura / fatura do të paguhet plotësisht nga PKK jo më vonë se 5 ditë nga data e pranimit të faturës. Pagesa konsiderohet e realizuar kur paratë depozitohen në llogarinë bankare të KOSTT.
- 7.2.4 Në rast të vonesës së pagesës, KOSTT do të ngarkojë PKK me normën e interesit ligjor të llogaritur në përputhje me ligjin.
- 7.2.5 PKK do të paguajë shumën totale të deklaruar në faturë brenda afatit të përcaktuar, pa të drejtën e kompensimit, përkatësisht barazimit, nëse KOSTT ka ndonjë detyrim të pazgjidhur ndaj PKK në çfarëdo baze.
- 7.2.6 Nëse PKK dështon të shlyejë detyrimet e veta financiare sipas kësaj kontrate, në drejtim të KOSTT brenda afatit të përcaktuar, KOSTT do të ketë të drejtë ti pezulloj PKK-së të drejtën për programet

	<b>Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive</b> <i>ver. 3.0</i>	<b>PR-MO-001</b> <i>Faqe 21 nga 32</i>
---	--	---

e nominuara, të ekzekutoj caktimin e kapaciteteve, të përdorë kapacitetin e alokuar dhe të marr pjesë në të gjitha ankandet e kapaciteteve, përfshirë alokimi intraditor i të drejtës së kapacitetit, derisa detyrimet e tij të përcaktohen sipas procedurave.

- 7.2.7 (1) nëse ndonjë shumë e faturuar kontestohet tërësisht apo pjesërisht nga PKK, PKK do të paguaj tërë shumën sipas kushteve të Nenit 7.2 dhe do të dorëzoj një shkresë svaruese e cila paraqet kundërshtimet e saj për KOSTT, brenda 3 ditë të punës nga data e pranimit. KOSTT shqyrton kërkesën e pranuar dhe dërgon përgjigjen e saj në lidhje me kërkesën e PKK brenda 3 ditëve të punës nga data e pranimit të saj.
- (2) Çfarëdo përmirësimi ose rregullimi i cili rezulton nga zgjidhja miqësore e kërkesës ose nga vendimi përfundimtar i gjyqit do të zbatohet brenda 5 dite të punës nga data e zgjidhjes së kontestit.

## 8 LIGJI I APLIKUESHËM

- 8.1 Kjo kontratë është përpiluar dhe e kushtëzuar me Legjislacionin Kosovar.
- 8.2 Çfarëdo kontesti që del nga përpilimi dhe/ose zbatimi i kësaj kontrate, i cili nuk mund të zgjidhet në mënyrë miqësore, do të dorëzohet dhe zgjidhet në gjykatë.
- 8.3 Nëse ndonjë dispozitë e kësaj kontrate apo anekset e saj bien në konflikt me ndonjë dispozitë të Rregullave të Tregut ose Kodit të Rrjetit të Transmetimit, dispozitat e aplikueshme të Rregullave të Tregut ose Kodit të Rrjetit të Transmetimit do të mbizotërojnë.
- 8.4 Rezultati i ankandit mund të ankimohet te ZRrE nga PKK nëse dispozitat e procedurës nuk janë vënë në fuqi.

## 9 DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### 9.1 DOKUMENTET E KONTRATËS

Aneksi 1 është pjesë e kësaj kontrate.

### 9.2 NJOFTIMET

- 9.2.1 Personat e autorizuar për implementimin e kësaj kontrate janë përcaktuar në Aneksin nr. 1.
- 9.2.2 Palët marrin masa që të mundësojnë që personat kontaktues të përcaktuar në Aneksin nr. 1 të mund të kontaktohen me telefon ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshkruar në Aneks.
- 9.2.3 Secila palë duhet të njoftoj tjetren me shkrim për çfarëdo ndryshimi në informatat kontaktuese të përshkruara në Aneksin nr. 1 së paku brenda shtatë (7) ditëve të punës para se ndryshimi të hyn në fuqi.

### 9.3 KOHËZGJATJA

- 9.3.1 Kjo kontratë bëhet efektive në datën e nënshkrimit të saj nga të dyja palët. Kjo kontratë është efektive deri në anulimin e saj nga cilado palë, sipas dispozitave të Nenit 9.5 të kësaj kontrate ose derisa PKK të njoftoj për anulimin e saj.

### 9.4 REVIDIMI I KONTRATËS

- 9.4.1 Nëse propozohet nga ndonjë nga palët, kontrata e nënshkruar nga të dy palët mund të rinnovohet, ndryshohet ose plotësohet me adendum, gjithashtu për të përfshirë dispozitat ligjore pas nënshkrimit të saj. Çfarëdo ndryshimi i dispozitave të kësaj kontrate mund të bëhet me adendum.

	<b>Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive</b>	PR-MO-001
	ver. 3.0	Faqe 22 nga 32

9.4.2 Palët pajtohen për revidimin e kësaj kontrate pas kërkesës me shkrim të ndonjërs prej palëve nëse:

- a) Operimi i Sistemit të Transmisionit të Kosovës jo favorshëm ndikohet me implementimin e kësaj Kontrate;
- b) Paraqiten rrithana apo dispozita të reja ligjore të cilat drejtpërdrejtë ose tërthorazi ndikojnë jo favorshëm në aftësinë e palës për të implementuar këtë Kontratë.

## 9.5 ANULIMI

9.5.1 Nëse Palët nuk pranojnë ndryshimin e kontratës brenda katërmëdhjetë (14) ditëve kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës me shkrim, në pajtim me dispozitat e Nenit 9.4 të kësaj kontrate, të dërguar nga njëra palë për tjetrën, cilado palë mund të anuloj këtë kontratë njëanshëm përsyén, obligimet aktuale të pagesës bëhen efektive menjëherë ose në datën e caktuar nga KOSTT në njoftimin për mbyllje.

9.5.2 Çfarëdo faji i cilësdo palë lidhur me ndonjë obligim i cili rezulton nga ose përcaktohet në këtë Kontratë, pa qenë dëmtues për ndonjë nga të drejtat e tyre, do t'i jep palës tjetër të drejtën që njëanshëm të anuloj këtë kontratë brenda nëntëdhjetë (90) ditëve kalendarike prej datës së njoftimit me postë, të regjistruar nga pala fajtore, ose kushtëzuar nga pala fajtore në mënyrë që të mbuloj humbjen brenda tridhjetë (30) dite kalendarike nga koha e njoftimit.

9.5.3 Kjo kontratë konsiderohet e anuluar në rast të térheqjes së PKK ose datës së revokimit kur térheqja ose revokimi bëhen efektive.

9.5.4 KOSTT mund, pa dëmtuar ndonjë nga të drejtat e veta, njëanshëm të anuloj këtë Kontratë me njoftimin e regjistruar, i cili bëhet efektiv brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e prezantimit të tij ose nga data pasuese e përcaktuar nga ofruesi në situatat vijuese:

- a) PKK nuk është në gjendje të përbushë përgjegjësitë e veta si përcaktohet në Kapitullin 3 të kësaj Kontrate.
- b) PKK nuk është në gjendje të përbush obligimet e veta të pagesës si përcaktohet në Kapitullin 7 të kësaj Kontrate;
- c) Suspendimi ose térheqja e ndonjë autorizimi, licence ose miratimi për PKK për të kryer aktivitetin e vet komercial sipas Kapitullit 9.10 të kësaj Kontrate;
- d) PKK ka humbur statusin e vetë të pjesëtarit të ankandit, sipas kushteve të procedurës;
- e) Bankrotimit të PKK ose ndonjë veprimi tjetër ligjor bazuar në likuiditetin e PKK ose vështirësitë financiare, procedurat e likuidimit ose ndarjes së PKK në dy kompani;
- f) Aktiviteti komercial dhe/ose teknik i PKK shpie në kërcënimin e sigurisë së operimit të sistemit të transmetimit.

## 9.6 FORCA MADHORE

9.6.1 Palët nuk do të janë përgjegjëse për mos-përbushjen e térësishme ose të pjesërishme të obligimeve që dalin nga kjo kontratë, nëse mos-përbushja e obligimeve është shkaktuar nga një situatë e Forcës Madhore. Rrethanat e Forcës Madhore janë ato të cilat mund të paraqiten gjatë implementimit të kësaj Kontratë, si rezultat i ngjarjeve të pa parashikueshme, si veprimet nga natyra, luftës, embargos të cilat kanë qenë të pa parashikueshme nga palët me nënshkrimin e Kontratës dhe janë përtej dëshirës ose kontrollit të palëve.

9.6.2 Pala e cila deklaron për situatën e Forcës Madhore duhet të njofoj palën tjetër me shkrim brenda 48 orëve të shfaqjes së situatës së Forcës Madhore, gjithashtu vlerësimi i periudhës kohore kur

	<b>Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive</b>	PR-MO-001
	ver. 3.0	Faqe 23 nga 32

efektet e saj pushojnë, me një afat për konfirmim prej pesë (5) ditë të punës për konfirmim për autoritetet e emëruara të konfirmojnë situatën e Forcës Madhore në lokacionin e ndodhjes së saj.

- 9.6.3 Mos përmbushja e obligimit për të njoftuar shfaqjen e situatës së Forcës Madhore nuk anulon efektin e shkarkimit të përgjegjësive të veta, por përfshinë obligimin e palës e cila ka pasur të prezantoj njoftimin, për të mbuluar dëmet e shkaktuara palës tjetër për shkak të mos komunikimit.

## 9.7 KONFIDENCIALITETI

- 9.7.1 Palët do të mbajnë dispozitat e kësaj kontrate strikt në konfidencë si dhe çfarëdo dokumenti tjetër dhe/ose pjesë të informatës të shkëmbyer nga palët në lidhje me këtë Kontratë. Përashtim nga kjo bën:

- 1) Informatat e kërkua nga autoritetet, sipas legjisacionit aktual;
- 2) Informatat të cilat janë bërë njohuri publike para nënshkrimit të Kontratës.

- 9.7.2 KOSTT lejohet dhe PKK pajtohet të komunikohet plotësisht ose pjesërisht ndonjë përcaktim konfidential, dokumenti dhe/ose pjesa e informatës për të gjithë operatorët tjerë të rrjetit, sipas Rregullave të Tregut, Kodit të Rrjetit të Transmetimit dhe rregulloreve tjera ndërkombëtare, kur kjo kërkohet me qëllim të garantimit të sigurisë dhe besueshmërisë së operimit të Sistemit të Transmetimit të Kosovës ose sistemeve të transmisionit të vendeve fqinje.

## 9.8 DËMTIMET

- 9.8.1 Asnjëra palë nuk është përgjegjëse për humbjen, e as dëmtimin, e shkaktuar palës tjetër, përveç situatave kur ka vepruar me qëllim, përfshirë dështimin e qëllimshëm për të vepruar, ose me neglizhencë të madhe.
- 9.8.2 Për mos përmbushjen e pjesshme ose tërësishme të obligimeve të tyre si përcaktohet në këtë kontratë, palët janë përgjegjëse sipas legjisacionit aktual.

## 9.9 PAVLEFSHMËRIA

- 9.9.1 Pavlefshmëria e një ose më shumë dispozitave të kësaj Kontrate nuk do të prish vlefshmërinë e dispozitave tjera.

## 9.10 LICENCAT DHE KONTRATAT

- 9.10.1 Gjatë implementimit të kësaj kontrate, PKK duhet të posedoj, në çdo kohë, të gjitha autorizimet, licencat ose/dhe miratimet e nevojshme për të kryer obligimet ose të drejtat e veta si përcaktohet në këtë Kontratë.

9.10.2 Kjo Kontratë bëhet efektive në datën e nënshkrimit të saj.

9.10.3 Kjo kontratë është përgatitur dhe nënshkruar në dy kopje origjinale, nga një kopje për KOSTT dhe një për PKK.

	<b>Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive</b>	<b>PR-MO-001</b>
	<i>ver. 3.0</i>	<i>Faqe 24 nga 32</i>

[PKK]

**OPERATORI I SISTEMIT, TRANSMISIONIT DHE  
TREGUT, SH.A**

	<b>Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive</b>	PR-MO-001
	ver. 3.0	Faqe 25 nga 32

**Aneksi 1 i MKAK:****PERSONAT KONTAKTUES DHE INFORMATAT KOMERCIALE****Kontakti Komercial:**

Emri:

Telefoni:

e-maili:

Telefoni mobil:

**Kontakti Teknik:**

Emri:

Telefoni:

e-maili:

Telefoni mobil:

**SHTOJCA 3****Formulari i Kërkesës për Transferimin e Kapacitetit Interkonektiv**



## Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive

PR-MO-001

ver. 3.0

Faqe 26 nga 32

Data e paraqitjes së kërkesës: \_\_\_\_\_

### 1. Kërkesë e detyrueshme për transferimin e Kapacitetit nga të dy Pjesmarrësit e Tregut së bashku

Kufiri / Drejtimi	Ankandi	Periudha e përdorimit të të drejtave të Kapacitetit	Kapaciteti
		dd.mm.yyyy - dd.mm.yyyy	MW
Kosovë – Serbi			
Kosovë – Shqipëri			
Kosovë – Mali i Zi			
Kosovë – Maqedoni e Veriut			
Serbi – Kosovë			
Shqipëri – Kosovë			
Mali i Zi – Kosovë			
Maqedoni e Veriut – Kosovë			

### 2. Pranimi i Transferimit të Kapacitetit

	Pala Dhënëse	Pala Marrëse
Emri i Kompanisë		
Personi i autorizuar		



## Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive

PR-MO-001

ver. 3.0

Faqe 27 nga 32

Nr. Tel.		
Nr. Fax.		
E-mail		
Nënshkrimi dhe Vula		

### 3. Konfirmimi i "KOSTT sh.a."

Personi i autorizuar	
Data e konfirmimit	
Koment	
Nënshkrimi dhe Vula	

### SHTOJCA 4

#### APLIKACIONI PER Ç'REGJISTRIM NË ANKANDIN E KAPACITETEVE INTERKONETKTIVE

Ju lutem kompletioni formën dhe dërgojeni në KOSTT: Ndërtesa e KOSTT, Rr. Isa Boletini. Nr. 39  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës ose përmes email adresës: schedule1@kostt.com



## Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive

PR-MO-001

ver. 3.0

Faqe 28 nga 32

Me këtë ne kërkojmë të ç'regjistrohem i pjesëmarrja në Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive

Ref	Kërkesat për informata	Detalet e Palës
1	Emri i plotë i kompanisë	
2	Emri, adresa, numri i faksit  Numri i telefonit dhe e-maili,  Adresa e personit për vëmendjen e të cilit duhet të shënohen njoftimet	
3	Efektive Deri në Datën e Térheqjes	

Ne deklarojmë se Detajet e Palës Térheqëse (paraqit emrin e plotë ligjor të kompanisë) të paraqitura janë komplete dhe të sakta.

Nënshkruar: \_\_\_\_\_ në emër të Palës Térheqëse (paraqit emrin e plotë ligjor të kompanisë)

Emri \_\_\_\_\_

Titulli \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_

*Shënim: Këto informata do të përdoren nga KOSTT vetëm për qëllime administrative*

### Shtojca 5

#### FORMA E NDRYSHIMIT TË INFORMACIONIT

Data e dërgimit: \_\_\_\_\_

Ref	Kërkesat për informata	Detajet e Palës
	Emri i plotë i kompanisë	



## Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive

PR-MO-001

ver. 3.0

Faqe 29 nga 32

1	Adresa (zyra qendrore) e kompanisë	
	Kodi i regjistrat i kompanisë	
	Numri i identifikimit tatimor (PIB)	
	Numri i TVSH-së vetëm për personat juridik të huaj	
	Të dhënrat mbi përfaqësuesin tatimor (emri, adresa zyrtare, numri i identifikimit tatimor) vetëm për personat juridikë të huaj	
	Nr. e Licencës të lëshuar nga ZrrE	
	Adresa për dërgimin e marrëveshjeve	
	E-mail për dërgimin e marrëveshjeve	
2	Numri i llogarisë bankare	
3	Emri dhe mbiemri i drejtoreve	
	Nr.i telefonit	
	Nr.i faksit	
	E-mail	
4	Personi (ose personat) përgjegjës për çështjet financiare	
	Nr. i telefonit	
	Nr. i faksit	
	E-mail	
	E-mail për dërgimin e faturave	
	Personi (ose personat) përgjegjës për pjesëmarrje në procedurën e alokimit	
	Nr. i telefonit	



## Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive

PR-MO-001

ver. 3.0

Faqe 30 nga 32

5	Nr. i faksit	
	E-mail	
6	Personi (ose personat) përgjegjës për dërgimin e nominimeve që ky person duhet të jetë i disponueshmë 24 orë në ditë, 365 ditë në vit	
	Nr.i telefonit	
	Nr.i faksit	
	E-mail	
	E-mail zyrtare për paraqitjen, dërgimin e nominimeve dhe mesazhet në këtë kontekst	
7	Personi (ose personat) përgjegjës për paraqitjen e çertifikatës së tregtisë së energjisë elektrike	
	Personi (ose personat) përgjegjës për nënshkrimin e çertifikatës së tregtisë të energjisë elektrike	
	Nr. i telefonit	
	Nr. i faksit	
	E-mail	
8	Kodi EIC lëshuar nga EIC zyra e lëshimit e autorizuar nga ENTSO-E	

Ne deklarojmë se Detajet e Palës Aplikuese (paraqit emrin e plotë ligjor të kompanisë) të paraqitura janë komplete dhe të sakta.

[SHKRUAJ: EMRI I KOMPANIS]

[SHKRUAJ: Emri dhe Mbiemri i PERSONIT TE AUTORIZUAR]

[SHKRUAJ: TITULLI PERSONI I AUTORIZUAR]



## Procedura për Alokimin e Kapaciteteve Interkonektive

PR-MO-001

ver. 3.0

Faqe 31 nga 32

[HAPSIRA PER: NENSHKRIMIN E PERSONIT TE AUTORIZUAR]

[HAPSIRA PER: VULEN E KOMPANISE]

*Shënim: Këto informata do të përdoren nga KOSTT vetëm për qëllime administrative*

### SHTOJCA 6

#### LISTA E PERSONAVE TË KONTAKTIT NË KOSTT

Emri	Titulli	Telefoni/ Fax-i	E-mail
<b>Për alokimin e kapaciteteve interkonektive</b>			
Burbuqe Hasani	Menaxhere e sektorit të operimit të tregut	+ 383 38 501 301 162	<a href="mailto:Burbuqe.hasani@kostt.com">Burbuqe.hasani@kostt.com</a>
Schedule1	Operatorë të skedulimit	+ 383 38 549 063	<a href="mailto:schedule1@kostt.com">schedule1@kostt.com</a>
<b>Për nominimet</b>			
Burbuqe Hasani	Menaxhere e sektorit të operimit të tregut	+ 383 38 501 301 162	<a href="mailto:Burbuqe.hasani@kostt.com">Burbuqe.hasani@kostt.com</a>
Schedule1	Operatorë të skedulimit	+ 383 38 549 063	<a href="mailto:schedule1@kostt.com">schedule1@kostt.com</a>
<b>Për alokim intraday dhe nominim D</b>			
QD1	Dispeçer	+ 383 38 501 301 111 + 383 38 501 301 112	<a href="mailto:Qd1@kostt.com">Qd1@kostt.com</a>



**Procedura për Alokimin e Kapaciteteve  
Interkonektive**

**PR-MO-001**

*ver. 3.0*

*Faqe 32 nga 32*

		+ 383 38 501 301 113	
<b>Për çështje te pagesave</b>			
Sherif Dedaqi	Menaxher per barazim perfundimtar	+ 383 38 501 301 164	<a href="mailto:Sherif.dedaqi@kostt.com">Sherif.dedaqi@kostt.com</a>